

## Vendim nr. 207 datë 30.09.2024

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, i përbërë nga:

Holta Zaçaj,	Kryetare
Sonila Bejtja,	Anëtare
Genti Ibrahimi,	Anëtar

në datën 30.09.2024 mori në shqyrtim paraprak kërkesën nr. 30 (A) 2024 të Regjistrit Themeltar, që u përket:

**KËRKUES:** AHMET SPAHIU dhe KUJTIM SPAHIU, të përfaqësuar nga studioja ligjore “Petani”, me prokurë.

**OBJEKTI:** Shfuqizimi i vendimit nr. 00-2023-5464, datë 22.12.2023 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë, si i papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.

**BAZA LIGJORE:** Nenet 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pika 1, shkronja, “i”, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë (*Kushtetuta*); nenet 24, 27, 31, 49, pika 3, shkronja “e”, 50, pika 4, 51/a, 71, 71/a, shkronjat “a”, “b” dhe “c” dhe 76, pika 6, të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar (*ligji nr. 8577/2000*).

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese (*Kolegji*), pasi dëgjoi relatorin e çështjes Genti Ibrahimi, shqyrtoi kërkesën, dokumentet shoqëruese, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

### V Ë R E N:

#### I

#### Rrethanat e çështjes

1. Shtetasit Amet Spahiu dhe Kujtim Spahiu (*kërkuesit*) janë trashëgimtarë ligjorë të të ndjerit Sh.S. Në bazë të vërtetimit të pronësisë të lëshuar nga hipoteka në datën

21.04.1992, rezulton që në bazë të aktit publik nr. 6827/4278, datë 09.11.1939, në favor të vëllezërve A.Gj. dhe Sh.Gj., figuronte prona prej 91 dynymësh tokë prej tokave të Bashkisë Durrës, sipas kufizimeve përkatëse.

2. Komisioni i Kthimit dhe Kompensimit të Pronave (KKKP), Durrës, me vendimin nr. 222, datë 13.01.1994 (*vendimi nr. 222/1994*), ka vendosur të njohë të drejtën e pronësisë së shtetasit A.S. për një sipërfaqe prej 91 dynymësh, 9.88 dynymësh prej të cilave janë shitur, duke mbetur 82.120 dynymë tokë. Sipas këtij vendimi, këtij shtetasi i njihet një sipërfaqe e lirë 5000 m<sup>2</sup>, ndërsa 77.120 m<sup>2</sup> i kompensohen në bazë të ligjit nr. 7501, datë 19.07.1991 “Për tokën”, të ndryshuar.

3. Kërkuesi Kujtim Spahiu, në cilësinë e njërit prej trashëgimtarëve ligjorë të të ndjerit Sh.S., duke mos qenë dakord me vendimin nr. 222/1994 të KKKP-së, Durrës dhe duke pretenduar se sipërfaqja e tokës prej 80 dynymësh, të ndodhur në lagjen nr. 13, Plazh Durrës, e trajtuar me anë të këtij vendimi në favor të A.S., nuk ka qenë vetëm në pronësi të tij, por edhe e të vëllait të tij të ndjerë, Sh. S., e ka kundërshtuar gjyqësish vendimin e KKKP-së, Durrës, duke depozituar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Durrës kërkesëpadi, me objekt anulimin pjesërisht të tij.

*(i) Procesi i parë gjyqësor*

4. Pas shqyrtimit gjyqësor të kërkesëpadisë, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Durrës, me vendimin nr. 338, datë 17.02.1997 (*vendimi nr. 338/1997*), ka vendosur rrëzimin e saj, si të pabazuar në prova dhe në ligj, pasi ka vlerësuar se i ndjeri A.S. ka qenë pronar i vetëm i sipërfaqes së njohur dhe të kthyer me vendimin nr. 222/1994 të KKKP-së, Durrës.

5. Vendimi nr. 338/1997 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës ka qenë objekt kundërshtimi i vazhdueshëm në shkallët e tjera të gjykimit dhe pas disa rigjykimesh Gjykata e Apelit Durrës, me vendimin nr. 503, datë 17.10.2002 (*vendimi nr. 503/2002*), ka vendosur ndryshimin e vendimit nr. 338/1997 të gjykatës së shkallës së parë, si dhe të vendimit nr. 222/1994 të KKKP-së, Durrës, duke njohur bashkëpronësinë për pasurinë e trajtuar me këtë vendim ndërmjet A.S. dhe Sh.S. Gjykata e apelit ka urdhëruar Zyrën Vendore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme (ZVRPP), Durrës të kryejë veprimet përkatëse. Kundër këtij vendimi kanë ushtruar rekurs trashëgimtarët ligjorë të të ndjerit A.S.

6. Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 341, datë 12.02.2004 (*vendimi nr. 341/2004*), ka vendosur prishjen e vendimit nr. 503/2002 të Gjykatës së Apelit Durrës dhe lënien në fuqi të vendimit nr. 338/1997 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës.

*(ii) Procesi i dytë gjyqësor*

7. Nga ana tjetër, një prej trashëgimtarëve ligjorë të të ndjerit A.S., shtetasja V.K., ka kërkuar gjyqësish ndryshimin e vendimit nr. 222/1994 të KKKP-së, Durrës, për sa i përket sipërfaqes së tokës të kthyer në natyrë me anë të këtij vendimi. Ajo ka kërkuar kthimin në natyrë trashëgimtarëve ligjorë të të ndjerit A.S. edhe të një sipërfaqeje prej 8212 m<sup>2</sup> tokë truall, që përfaqëson 10% të sipërfaqes prej 82 dynmësh të njohur me anë të këtij vendimi.

8. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Durrës, me vendimin nr. 1396, datë 26.10.2001, ka vendosur pranimin e kërkesëpadisë së saj dhe ndryshimin e vendimit nr. 222/1994 të KKKP-së, Durrës, duke i kthyer të lirë në natyrë sipërfaqen e truallit 8212 m<sup>2</sup>, të ndodhur brenda sipërfaqes 82 dynmë, si sipërfaqe 10% në 11 parcela të specifikuara, sipas këtij vendimi. Kundër këtij vendimi është bërë ankim prej ndërhyrësve dytësorë në këtë proces gjyqësor civil, ndërmjet të cilëve edhe kërkuesi Kujtim Spahiu edhe shtetasi J.K., në cilësinë e trashëgimtarëve ligjorë të të ndjerit Sh.S.

9. Gjykata e Apelit Durrës, me vendimin 380, datë 01.07.2003 (*vendimi nr. 380/2003*), ka vendosur lënien në fuqi të vendimit të gjykatës së shkallës së parë, duke bërë një plotësim sipas të cilit sipërfaqja prej 8212 m<sup>2</sup> e ndodhur brenda sipërfaqes prej 82 dynmësh, që u është njohur trashëgimtarëve të A.S., u kthehet e lirë atyre së bashku me trashëgimtarët e Sh.S. Gjykata e apelit e ka cilësuar vendimin e gjykatës së shkallës së parë të bazuar në prova dhe në ligj dhe plotësimin e mësipërm e ka bërë duke u bazuar tërësisht në vendimin nr. 503/2002 të Gjykatës së Apelit Durrës, i cili kishte ndryshuar vendimin nr. 338/1997 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës dhe vendimin nr. 222/1994 të KKKP-së, Durrës, për sa i përket njohjes së pronësisë për sipërfaqen prej 82 dynmësh, duke njohur të ndjerët A.S. dhe Sh.S. si bashkëpronarë në pronën objekt vendimi të KKKP-së, Durrës.

10. Sipas shkresës nr. 592/1 prot., datë 21.07.2008 të ZVRPP-së, Durrës, ka rezultuar se sipërfaqja e tokës truall prej 8212 m<sup>2</sup>, e cila përfaqëson 10% të sipërfaqes së përgjithshme prej 82 dynmësh është regjistruar në ZVRPP-në, Durrës me numër hipotekar 136, në datën 10.07.2007, në bashkëpronësi të trashëgimtarëve ligjorë të të ndjerit A.S. dhe Sh.S., në bazë të vendimit nr. 380/2003 të Gjykatës së Apelit Durrës, i cili është dhënë më parë në kohë se vendimi nr. 341/2004 i Gjykatës së Lartë, që ka prishur vendimin nr. 503/2002 të Gjykatës së Apelit Durrës, duke e konsideruar të ndjerin A.S. si pronar të vetëm të sipërfaqes së tokës truall prej 82 dynmësh, si rrjedhim, duke lënë në fuqi vendimin e KKKP-së, Durrës.

*(iii) Procesi i tretë gjyqësor*

11. Duke pretenduar se janë pronarë të vetëm të sipërfaqes truall prej 82 dynmësh, objekt i vendimit nr. 222/1994 të KKKP-së, Durrës dhe të sipërfaqes së tokës truall prej 8212 m<sup>2</sup>, e cila përfaqëson 10% të sipërfaqes së njohur prej 82 dynmësh dhe të kthyer në natyrë në gjendje të lirë, paditësit Q.S., F.K. dhe Z.D., në cilësinë e trashëgimtarëve ligjorë të të ndjerit A. S., i janë drejtuar Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës me kërkesëpadi, me objekt detyrimin e të paditurve Ahmet Spahiu, Kujtim Spahiu dhe J. K. për t'i njohur pronarë të vetëm për shkak të trashëgimisë së pasurisë së lënë nga i ndjeri A.S., të sipërfaqeve të përcaktuara në padi; detyrimin e të paditurve të paguajnë vlerën e përdorimit të sendit; urdhërimin e ZVRPP-së, Durrës që të fshijë regjistrimin hipotekar nr. 90, datë 27.10.2008 për pjesën e pronës së regjistruar në bashkëpronësi me të paditurit dhe regjistrimin e saj në bashkëpronësi vetëm të trashëgimtarëve të A. S.; marrjen e masës së sigurimit të padisë, duke mos lejuar që në pronën e këtij shqyrtimi gjyqësor të kryhet ndonjë veprim juridik për tjetërsimin e saj tek të tretët, deri në zgjidhjen përfundimtare të çështjes.

12. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Durrës, me vendimin nr. 1209 (11-2013-2330), datë 03.05.2013, ka vendosur pranimin e kërkesëpadisë së paditësve Q.S., F.K. dhe Z.D., duke përcaktuar detyrimin e të paditurve Ahmet Spahiu, Kujtim Spahiu dhe J.K. të njohin paditësit Q.S., F.K. dhe Z.D. dhe trashëgimtarët e tjerë ligjorë të të ndjerit A.S., si pronarë të vetëm të pasurive të pasqyruara në dispozitivin e vendimit; detyrimin e kërkuesit Kujtim Spahiu t'i lirojë dhe dorëzojë paditësve dhe trashëgimtarëve të tjerë ligjorë të A.S. pasuritë nr. 40/181, 40/223-1, nr. 40/226 dhe nr.40/225-1; detyrimin e të paditurve Kujtim Spahiu dhe J.K. t'i lirojnë dhe dorëzojnë paditësve dhe trashëgimtarëve të tjerë ligjorë të A.S. pasuritë nr.40/164 dhe nr.40/259; detyrimin e kërkuesit Ahmet Spahiu t'i lirojnë dhe dorëzojnë paditësve dhe trashëgimtarëve të tjerë ligjorë të A.S. pasuritë nr. 40/226 dhe nr.40/225-1; detyrimin e palës së paditur, ZVRPP-së, Durrës, të fshijë nga regjistri hipotekar të paditurit Ahmet Spahiu, Kujtim Spahiu dhe J.K. si bashkëpronarë të pasurive të paluajtshme, sipas dispozitivit të vendimit; pushimin e gjykimit të çështjes civile lidhur me kërkimin e objektit të padisë që ka të bëjë me detyrimin e të paditurve për të paguar vlerën e përdorimit të sendit dhe marrjen e masës së sigurimit të padisë. Kundër këtij vendimi kanë paraqitur ankim të paditurit Ahmet Spahiu dhe Kujtim Spahiu.

13. Gjykata e Apelit Durrës, me vendimin nr. 734 (10-2015-1566), datë 02.07.2015, ka vendosur lënien në fuqi të vendimit të gjykatës së shkallës së parë, me arsyetimin se ai është marrë në zbatim të drejtë të ligjit procedural e material. Sipas gjykatës së apelit, për sa

kohë që me një vendim gjyqësor të formës së prerë, vendimi nr. 222/1994 i KKKP-së, Durrës, që ka njohur pronar të vetëm të truallit prej 82.120 dynmësh të ndjerin A.S., është konsideruar i ligjshëm, pretendimi i paraqitur në ankimin e të paditurve Ahmet Spahiu dhe Kujtim Spahiu, se janë posedues të ligjshëm të këtij trualli, për shkak të ekzistencës së vendimit nr. 380/2003 të Gjykatës së Apelit Durrës, është i pabazuar. Kundër këtij vendimi secili prej kërkuesve ka ushtruar rekurs. Kërkuesi Kujtim Spahiu ka paraqitur edhe një shtesë rekursi në datën 18.02.2021. Kundër rekurseve të mësipërme, në datën 12.10.2015, kanë paraqitur kundërrekruse të veçanta paditësit Q.S., F.K. dhe Z.D.

14. Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 00-2023-5464, datë 22.12.2023, ka vendosur mospranimin e rekurseve të kërkuesve, me arsyetimin se nuk përmbante shkaqe nga ato të parashikuara në nenin 472 të Kodit të Procedurës Civile (KPC), të cilat e bëjnë të cenueshëm vendimin e gjykatës së apelit.

15. Në datën 27.06.2024 kërkuesit i janë drejtuar Gjykatës Kushtetuese (Gjykata) me ankim kushtetues individual, sipas objektit të tij, i cili, pasi është plotësuar sipas kërkesave të ligjit nr. 8577/2000, është regjistruar në datën 12.07.2024.

16. Në lidhje me afatin për shqyrtimin paraprak të çështjes, të përcaktuar në nenin 47, pika 1, të ligjit nr. 8577/2000, bazuar në nenet 15, pika 2 dhe 21, pika 1, të Rregullores për Procedurat Gjyqësore të Gjykatës Kushtetuese, në këtë afat nuk llogaritet periudha e lejes vjetore të anëtarëve të Gjykatës, sipas nenit 18, pika 1, shkronja “b”, të po këtij ligji.

## II

### Pretendimet e kërkuesve

17. **Kërkuesit**, në mënyrë të përmbledhur, kanë pretenduar se u është cenuar:

17.1. *E drejta për proces të rregullt ligjor*, e garantuar nga neni 42 i Kushtetutës, në drejtim të *standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor*, pasi vendimet e gjykatave të faktit janë dhënë në kundërshtim me ligjin. Në krye të vendimit të gjykatës së shkallës së parë është shënuar se çështja ka marrë numër regjistri 102, datë 21.04.2009, ndërsa në paragrafin hyrës të vendimit thuhet se çështja ka nr. akti 102, datë 21.04.2013, pra me një diferencë prej 4 vjetësh, fakt që kombinon edhe me vendimin e dhënë në datën 03.05.2013, një muaj pasi ishin mbushur 4 vjet nga regjistrimi. Edhe vendimi i Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë është i cekët. Në të radhitet në mënyrë të përsëritur historiku i konfliktit mes palëve dhe në më pak se një faqe janë hedhur mendimet e Kolegjit Civil, pa

arsyetuar për paligjshmërinë dhe antikushtetutshmërinë e pretenduar në rekursin e paraqitur nga kërkuesit në këtë gjykim. Paradoksi i vendimit të Gjykatës së Lartë qëndron në faktin se ai është marrë shumë vite pas, kur problemi i bashkëpronësisë së palëve ndërgjyqëse ishte zgjidhur prej kohësh dhe kjo gjykatë e ka anashkaluar këtë fakt, duke mos e përmendur fare gjatë shqyrtimit të rekursit.

17.2. *Parimit të sigurisë juridike*, pasi është cenuar një e drejtë e fituar më parë nga kërkuesit përmes vendimit nr. 380/2003 të Gjykatës së Apelit Durrës. Gjykatat e faktit e më pas Gjykata e Lartë janë shprehur sërish me një vendim tjetër për të njëjtën pronë, e cila më parë u ishte njohur palëve në bashkëpronësi midis tyre. Kjo përbën mbivendosje të paligjshme vendimesh në shkelje flagrante të dispozitave ligjore procedurale dhe materiale.

17.3. *E drejta e pronës private*, e garantuar nga neni 41 i Kushtetutës, pasi:

17.3.1. Prona është fituar nga pala tjetër përmes një vendimi gjyqësor arbitrar dhe haptazi në kundërshtim me ligjin. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Durrës ka pranuar padinë e paditësve si trashëgimtarë të radhës së parë të trashëgimlënësit A.S. në të gjitha drejtimet, në mënyrën më të paligjshme të mundshme, duke i njohur pronarë për një sipërfaqe toke për të cilën palët ndërgjyqëse ishin njohur si bashkëpronarë përmes një vendimi tjetër gjyqësor. Gjykata e apelit e ka lënë në fuqi vendimin antiligjor të gjykatës së shkallës së parë dhe Gjykata e Lartë ka vendosur mospranimin e rekursit të kërkuesve kundër vendimit të gjykatës së apelit.

17.3.2. Provat vërtetojnë bashkëpronësinë e vëllezërve A.S. dhe Sh.S. për sipërfaqen e tokës objekt gjykimi. Sipas shkresës nr. 4752, datë 16.12.2019 të Drejtorisë Vendore të Agjencisë së Kadastrës Durrës, bashkëlidhur së cilës ndodhet një kopje e radhorit nr. 330 të vitit 1939, si dhe në notën e transkriptimit të marrë nga noteri rezulton se Bashkia Durrës i ka shitur A.Gj. dhe Sh.Gj. 91 dynymë tokë të Bashkisë Shkozet, sipas kufizimeve përkatëse. Mbi bazën e këtyre të dhënave, hipoteka e atëhershme ka lëshuar certifikata pronësie që dëshmojnë bashkëpronësinë e dy vëllezërve. Edhe ZVRPP-ja, Durrës ka lëshuar vërtetim në datën 21.04.1994, ku vërtetohet se në favor të të dy vëllezërve figuron prona prej 91 dynymësh në Shkozet të Durrësit, si dhe transaksionet që të dy

vëllezërit kanë bërë duke shitur copa toke ndër vite. Në datën 21.02.1997 ZVRPP-ja, Durrës ka lëshuar përsëri një vërtetim pronësie që ka të njëjtën përmbajtje, duke vërtetuar bashkëpronësinë e dy vëllezërve për tokën truall 91 dynymë. Situata konfliktuale ka ardhur si pasojë e vendimit nr. 222/1994 të KKKP-së, Durrës, përmes të cilit e drejta e pronësisë për këtë sipërfaqe tokë-truall i është njohur vetëm njërit prej vëllezërve.

### III

#### Vlerësimi i Kolegjit

##### A. Për legjitimitimin e kërkuësve

18. Çështja e legjitimitimit (*locus standi*) është një ndër aspektet kryesore që lidhet me nisjen e një procesi kushtetues. Sipas neneve 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pikat 1, shkronja “i” dhe 2, të Kushtetutës, si dhe nenit 71 të ligjit nr. 8577/2000, çdo individ, person fizik ose juridik, subjekt i së drejtës private dhe publike, mund të vërë në lëvizje Gjykatën për gjykimin përfundimtar të ankesave kundër çdo akti të pushtetit publik ose vendimi gjyqësor që cenon të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë. Ankimi kushtetues individual, në çdo rast, duhet të plotësojë kriteret e nenit 71/a të ligjit nr. 8577/2000, që lidhen me shterimin e mjeteve juridike efektive, afatin e paraqitjes së kërkesës, pasojat negative të pësuar në mënyrë të drejtpërdrejtë e reale, mundësinë për rivendosjen e së drejtës së shkelur, si dhe rregullimet e veçanta ligjore të shqyrtimit paraprak të kërkesës. Kriteret për pranueshmërinë e ankimit kushtetues individual janë të natyrës kumulative, në kuptimin që ato duhet të plotësohen njëkohësisht. Për pasojë, mjafton mosplotësimi i njërit prej tyre që kërkuësi të mos legjitimohet për vënien në lëvizje të gjykimit kushtetues.

19. Për sa më lart, Kolegji vlerëson se kërkuësit legjitimohen *ratione personae*, bazuar në nenet 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pika 1, shkronja “i”, të Kushtetutës, pasi janë palë në çështjen objekt të ankimit kushtetues individual, për rrjedhojë kanë interes të drejtpërdrejtë për vënien në lëvizje të këtij gjykimi kushtetues.

20. Në lidhje me kriterin e *shterimit të mjeteve juridike efektive*, në kuptim të nenit 131, pika 1, shkronja “f”, të Kushtetutës, kërkuësit i janë drejtuar Gjykatës pas përfundimit të procesit gjyqësor në të tria shkallët e gjyqësorit të zakonshëm dhe pasi kanë shteruar në formë e substancë mjetet e zakonshme të ankimit ndaj vendimeve të gjykatave më të ulëta. Për rrjedhojë, Kolegji çmon se kërkuësit nuk kanë mjet tjetër juridik në dispozicion për mbrojtjen e të drejtave të tyre kushtetuese përveç paraqitjes së ankimit kushtetues individual.

21. Për sa i takon legjitimitet *ratione temporis*, bazuar në nenin 71/a, pika 1, shkronja “b”, të ligjit nr. 8577/2000, afati për paraqitjen e ankimit kushtetues individual është 4 muaj nga konstatimi i cenimit të së drejtës. Në rastin kur ankimi ka të bëjë me një vendim të Gjykatës së Lartë, ky afat fillon nga data në të cilën vendimi i arsyetuar bëhet i disponueshëm për palët përmes depozitimit të tij në sekretarinë gjyqësore dhe publikimit në faqen zyrtare ose njoftimit elektronik të tij, në rast se palët kanë lënë të dhënat elektronike të kontaktit (*shih vendimet nr. 42, datë 19.09.2023; nr. 40, datë 14.09.2023 të Gjykatës Kushtetuese*).

22. Kolegji konstaton se vendimi i kundërshtuar i Gjykatës së Lartë mban datën 22.12.2023, ndërkohë që ankimi kushtetues individual është paraqitur në Gjykatë në datën 27.06.2024 dhe bashkëlidhur tij kërkuesit kanë paraqitur edhe një kopje të atij vendimi, në të cilin ndodhet shënimi i sekretarisë së Gjykatës së Lartë për datën 15.05.2024, në të cilën ata janë pajisur me vendimin e saj. Nga komunikimi me Gjykatën e Lartë ka rezultuar se ky vendim i Kolegjit Civil nuk është publikuar në faqen e saj zyrtare. Në këto rrethana, Kolegji vlerëson se data në të cilën kërkuesit janë njohur efektivisht me vendimin e Kolegjit Civil është data 15.05.2024, në të cilin ata janë pajisur me kopje të arsyetuar të tij nga sekretaria e Gjykatës së Lartë. Duke konsideruar këtë si datën nga e cila ka filluar të ecë për kërkuesit afati ligjor 4-mujor për paraqitjen e ankimit kushtetues individual, Kolegji vlerëson se kërkuesit legjitimohen edhe *ratione temporis*.

23. Në drejtim të legjitimitet *ratione materiae*, kërkuesit kanë pretenduar si cenimin e së drejtës për proces të rregullt ligjor, të garantuar nga neni 42 i Kushtetutës, në drejtim të standardit të arsytimit të vendimit gjyqësor, ashtu edhe cenimin e parimit të sigurisë juridike, për shkak se vendimet gjyqësore kanë cenuar një të drejtë të fituar më parë prej tyre po me vendim gjyqësor. Po kështu, kërkuesit kanë pretenduar edhe cenimin e së drejtës së pronës private, të parashikuar nga neni 41 i Kushtetutës, duke pretenduar se vendimet që ia kanë njohur pronësinë për sipërfaqen e truallit objekt konflikti gjyqësor palës tjetër në procesin gjyqësor janë arbitrare dhe haptazi në kundërshtim me ligjin, ndërkohë që ata ishin njohur si bashkëpronarë përmes një vendimi tjetër gjyqësor. Kolegji, duke pasur parasysh natyrën e këtyre pretendimeve dhe argumentet e parashtruara nga kërkuesit në mbështetje të tyre, vlerëson se ato kanë të bëjnë, në thelb, me mënyrën e arsytimit të gjykatave në drejtim të zgjidhjes së mosmarrëveshjes objekt konflikti gjyqësor dhe konkretisht mënyrës se si kanë vlerësuar pretendimet e kërkuesve në drejtim të së drejtës së pronës private të pretenduar të fituar prej tyre me një vendim tjetër gjyqësor, që është shprehur për të njëjtën pasuri të paluajtshme. Për rrjedhojë, Kolegji vlerëson që t'i shqyrtojë ato në vijim, në këndvështrim të

së drejtës për proces të rregullt të lidhur me të drejtën e pronës private dhe parimin e sigurisë juridike.

24. Kolegji vëren se në drejtim të standardit të arsytimit të vendimit kërkuesit kanë pretenduar se në krye të vendimit të gjykatës së shkallës së parë është shënuar se çështja ka marrë numër regjistri 102, datë 21.04.2009, ndërsa në fillim të vendimit thuhet se çështja ka nr. akti 102, datë 21.04.2013, pra me një diferencë prej 4 vjetësh, fakt që kombinon edhe me vendimin e dhënë në datën 03.05.2013, një muaj pasi ishin mbushur 4 vjet nga regjistrimi. Megjithatë, kërkuesit nuk kanë arritur të argumentojnë në lidhje me këtë pretendim pasojat e ardhura në të drejtat e tyre substanciale.

25. Po kështu, në drejtim të së drejtës së pronës private, kërkuesit kanë pretenduar edhe se ekzistojnë disa prova që vërtetojnë bashkëpronësinë e vëllezërve A.S. dhe Sh. S. Në jurisprudencën e saj Gjykata ka pohuar se çështjet e vlerësimit të fakteve dhe provave, si dhe të interpretimit të ligjit bëjnë pjesë në juridiksionin e gjykatave të zakonshme dhe nuk përfshihen në juridiksionin kushtetues (*shih vendimet nr. 30, datë 29.05.2023; nr. 33, datë 14.11.2022; nr. 3, datë 23.02.2016 të Gjykatës Kushtetuese*). Këto pretendime të kërkuesve, për nga natyra e tyre, kanë të bëjnë me çështje me natyrë thelbësisht ligjore dhe, si të tilla, i përkasin juridiksionit të zakonshëm gjyqësor. Për rrjedhojë, Kolegji vlerëson se kërkuesit nuk legjitimohen *ratione materiae* për këto pretendime, për sa kohë nuk kanë arritur t'i argumentojnë ato në aspektin kushtetues.

*B. Për pretendimin e cenimit të standardit të arsytimit të vendimit gjyqësor të lidhur me të drejtën e pronës private dhe parimin e sigurisë juridike*

26. Kërkuesit kanë pretenduar se drejta e pronës private është fituar nga pala tjetër përmes vendimeve gjyqësore arbitrare dhe haptazi në kundërshtim me ligjin. Sipas tyre, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Durrës ka pranuar padinë e paditësve si trashëgimtarë të radhës së parë të trashëgimlënësit A.S., në mënyrë të paligjshme, duke i njohur pronarë për një sipërfaqe toke për të cilën palët ndërgjyqëse ishin njohur si bashkëpronarë përmes një vendimi tjetër gjyqësor. Sipas kërkuesve, gjykata e apelit ka lënë në fuqi vendimin antiligjor të gjykatës së shkallës së parë, kurse Gjykata e Lartë ka vendosur mospranimin e rekursit me një vendim të cekët, në të cilin radhitet në mënyrë të përsëritur historiku i konfliktit mes palëve dhe nuk arsyeton për paligjshmërinë dhe antikushtetutshmërinë e pretenduar në rekurs. Po sipas kërkuesve, vendimi i Gjykatës së Lartë është marrë pasi shumë vitesh, kur problemi i bashkëpronësisë së palëve ndërgjyqëse ishte zgjidhur prej kohësh dhe ajo e ka anashkaluar

këtë fakt, duke mos e përmendur gjatë shqyrtimit të rekursit. Sipas kërkuessve, gjykatat u kanë cenuar një të drejtë të fituar me vendimin nr. 380/2003 të Gjykatës së Apelit Durrës, duke u shprehur sërish për të njëjtën pronë, e cila më parë u ishte njohur palëve në bashkëpronësi midis tyre.

27. Gjykata ka theksuar se e drejta për një proces të rregullt ligjor përfshin edhe të drejtën për të pasur një vendim gjyqësor të arsyetuar, që i garantohet individit nga nenet 42 dhe 142, pika 1, të Kushtetutës. Arsyetimi i vendimeve është element thelbësor i një vendimi të drejtë. Sipas Gjykatës, zbatimi i ligjit është detyrë e gjykatave të juridiksionit të zakonshëm për qëllim të procesit gjyqësor që ato zhvillojnë, ndërsa detyra e saj është të vlerësojë nëse gjatë procesit gjyqësor ka pasur shkelje të të drejtave kushtetuese, si dhe nëse zbatimi i ligjit ka qenë eventualisht arbitrar, në kuptimin që të bjerë ndesh haptazi me konceptin e gjykimit të drejtë të përcaktuar në nenin 42 të Kushtetutës (*shih vendimet nr. 30, datë 29.05.2023; nr. 33, datë 14.11.2022; nr. 3, datë 23.02.2016 të Gjykatës Kushtetuese*). Gjykata nuk vepron si gjykatë e shkallës së katërt dhe për këtë arsye vendimet e gjykatave të juridiksionit të zakonshëm nuk vihen në dyshim, përveç rasteve kur gjetjet e tyre mund të konsiderohen si arbitrare ose haptazi të paarsyeshme. Thënë ndryshe, Gjykata vepron në rastin kur gabimi ligjor ose faktik nga gjykatat e juridiksionit të zakonshëm është aq i dukshëm, sa një gjykatë e arsyeshme nuk mund ta kishte bërë ndonjëherë ose i tillë që gjykimin e bën të padrejtë (*shih vendimin nr. 30, datë 29.05.2023 të Gjykatës Kushtetuese*).

28. Po sipas Gjykatës, arsyetimi i kufizuar nuk cenon standardin e arsyetimit të vendimit gjyqësor, përderisa shpreh në thelb shkaqet e mospranimit të rekursit nga ana e Kolegjit të Gjykatës së Lartë, gjatë shqyrtimit paraprak të tij në dhomën e këshillimit (*shih vendimet nr. 28, datë 01.11.2022; nr. 2, datë 11.02.2021; nr. 21, datë 16.04.2015 të Gjykatës Kushtetuese*).

29. Për sa i përket së drejtës së pronës private, të parashikuar nga neni 41 i Kushtetutës, Gjykata ka theksuar se në një shtet demokratik individit duhet t'i garantohet gëzimi i qetë dhe pa pengesa të paarsyeshme ose joproporcionale i kësaj të drejte, si një ndër aspektet më thelbësore të shoqërisë demokratike. E drejta e pronës realizohet përmes ushtrimit të tagrave të pronësisë dhe se cenimi qoftë edhe i pjesshëm i çdo tagri të pronësisë përbën, në vetvete, cenimin e së drejtës të pronës në tërësinë e saj (*shih vendimet nr. 53, datë 31.10.2023; nr. 36 datë 21.04.2017; nr. 25, datë 28.04.2014 të Gjykatës Kushtetuese*). Kurse për së u përket vendimeve gjyqësore të formës së prerë, në këndvështrim të parimit të sigurisë juridike, kur gjykata ka vendosur përfundimisht për një çështje, vendimi i saj nuk duhet të

vihet në dyshim. Kur vendimi ka marrë formë të prerë, ai është i detyrueshëm për palët, trashëgimtarët e tyre, për personat që tërheqin të drejta nga palët, për gjykatën që ka dhënë vendimin dhe për të gjitha gjykatat dhe institucionet e tjera dhe asnjë gjykatë nuk mundet të gjykojë sërish të njëjtën padi kundrejt të njëjtave palë (*shih vendimet nr. 33, datë 14.11.2022; nr. 10, datë 13.02.2017 të Gjykatës Kushtetuese*).

30. Duke iu rikthyer rastit konkret, Kolegji vëren se trashëgimtarët e A.S. e kanë fituar të drejtën e pronës për truallin 82 dynymë në bazë të vendimit nr. 222/1994 të KKKP-së, Durrës, i cili është kundërshtuar në gjykatën e shkallës së parë nga kërkuesit, si trashëgimtarë të Sh.S. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Durrës, me vendimin nr. 338/1997, ka vendosur rrëzimin e kësaj padie si të pabazuar në prova dhe në ligj, pasi ka vlerësuar se i ndjeri, shtetasi A.S., ka qenë pronar i vetëm i sipërfaqes së njohur dhe të kthyer me vendimin nr. 222/1994 të KKKP-së, Durrës. Ky vendim është ndryshuar nga Gjykata e Apelit Durrës me vendimin nr. 503/2002, duke njohur bashkëpronësinë e shtetasve A.S. dhe Sh.S. për pasurinë e paluajtshme objekt të vendimit të KKKP-së, Durrës. Më tej, Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 341/2004 ka vendosur prishjen e vendimit nr. 503/2002, të gjykatës së apelit dhe ka lënë në fuqi të vendimin nr. 338/1997 të gjykatës së shkallës së parë. Në këtë kuptim, trashëgimtarët e A.S. gëzojnë titullin e pronësisë së truallit 82 dynymë, të cilin e kanë fituar me vendim gjyqësor të formës së prerë.

31. Nga ana tjetër, Kolegji konstaton se pretendimet e kërkuesve në drejtim të së drejtës së pronës dhe të sigurisë juridike janë mbështetur në vendimin nr. 380/2003 të Gjykatës së Apelit Durrës, sipas të cilit sipërfaqja prej 8212 m<sup>2</sup> e ndodhur brenda sipërfaqes prej 82 dynymësh, që u është njohur trashëgimtarëve të A.S., u kthehet e lirë atyre së bashku me trashëgimtarët e Sh.S. Vendimi i mësipërm është i bazuar te vendimi nr. 503/2002 i së njëjtës gjykatë, i cili rezulton që të jetë prishur nga Gjykata e Lartë dhe, si rrjedhim, nuk ka fuqi ligjore. Një fakt i tillë është konstatuar edhe në vendimmarrjen e fundit të gjykatave të juridiksionit të zakonshëm.

32. Është pikërisht mbi bazën e këtyre vendimeve gjyqësore që gjykatat, në procesin gjyqësor objekt të ankimit kushtetues individual, kanë vendosur pranimin e kërkesëpadsisë së trashëgimtarëve ligjorë të të ndjerit A.S., duke përcaktuar detyrimin e kërkuesve që t'i njohin ata pronarë të vetëm të pasurive që ndodhen në zonën kadastrale nr. 8518, në lagjen nr. 13, Plazh Durrës dhe për t'i liruar dhe dorëzuar paditësve pasuritë që kishin në posedim. Në vendimmarrjen e saj gjykata e shkallës së parë është bazuar në arsyetimin se gjatë hetimit gjyqësor të çështjes civile ka rezultuar e provuar se paditësit si trashëgimtarë ligjorë të të

ndjerit A.S. janë konsideruar me vendim gjyqësor të formës së prerë si pronarë të vetëm të pronës prej 82 dynymësh, pjesë përbërëse të së cilës janë pasuritë që posedohen nga kërkuesit, të cilët nuk rezultojnë ta kenë fituar posedimin për këto pasuri në mënyrë të ligjshme (*shih faqet 19 dhe 20 të vendimit nr. (11-2013-2330) 1209, datë 03.05.2013 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës*).

33. Gjykata e apelit, e vënë në lëvizje mbi ankimin e kërkuesve, ka vendosur lënien në fuqi të vendimit të gjykatës së shkallës së parë, me arsyetimin se pretendimi në ankim ishte mbështetur në vendimin nr. 380/2003 të Gjykatës së Apelit Durrës, i cili nuk kishte fuqi ligjore, për sa kohë rezultojnë të jetë i bazuar në vendimin nr. 503/2002 të së njëjtës gjykatë, i cili është prishur më pas nga një gjykatë më e lartë. Po sipas gjykatës së apelit, për sa kohë që me një vendim gjyqësor civil të një gjykate më të lartë është përcaktuar një mënyrë zgjidhjeje e përkatësisë së pronësisë për një send të paluajtshëm (kjo në tërësinë e tij), nga pikëpamja ligjore nuk mund të pranohet në të njëjtën kohë një mënyrë tjetër e përkatësisë së pronësisë të një pjese të kësaj prone, qoftë kjo e përcaktuar edhe me një vendim gjyqësor të një shkalle më të ulët, që në rastin konkret edhe ky i fundit ka rezultuar se është i mbështetur në një vendim që më pas është prishur (*shih faqet 10 dhe 11 të vendimit nr. 10-2015-1566 (734), datë 02.07.2015 të Gjykatës së Apelit Durrës*).

34. Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë ka vendosur mospranimin e rekursit të kërkuesve, me arsyetimin se ai nuk përmbante shkaqe nga ato të parashikuara në nenin 472 të KPC-së. Sipas Kolegjit Civil, gjykatat e faktit kanë respektuar normat procedurale, të cilat mund të çojnë në pavlefshmërinë e vendimit gjyqësor ose të procedurës së gjykimit dhe nuk rezultojnë të ketë shkaqe të rënda procedurale, të cilat të kenë ndikuar dukshëm në dhënien e vendimeve. Sipas tij, palëve iu është dhënë mundësia të realizojnë të drejtën e tyre të mbrojtjes, të paraqesin prova, të njihen me provat e palës kundërshtare, të debatojnë në lidhje me to, të shprehin qëndrimin e tyre për zgjidhjen e mosmarrëveshjes etj., duke u respektuar të gjitha parimet bazë të zhvillimit të një procesi të rregullt ligjor. Kolegji Civil ka vlerësuar se gjykata e apelit ka respektuar dhe zbatuar drejt dispozitat e ligjit material, ka bërë një cilësim të drejtë të fakteve dhe rrethanave që lidhen me mosmarrëveshjen, ka kryer një analizë juridike të plotë të provave dhe e ka zgjidhur mosmarrëveshjen në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi, duke iu dhënë përgjigje shteruese pretendimeve të ngritura nga palët, ndërkohë që pretendimet që ngrenë çështje të vlerësimit të provave dalin jashtë juridiksionit rishikues dhe ligjor të Gjykatës së Lartë (*shih paragrafët 30 dhe 31 të vendimit nr. 00-2023-5464, datë 22.12.2023 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë*).

35. Në kuptim të sa më sipër, Kolegji vëren se gjykatat e faktit kanë pranuar padinë e palës paditëse dhe kanë rrëzuar pretendimet e kërkuësve, pasi kanë vlerësuar se pala paditëse e ka fituar me vendim gjyqësor të formës së prerë të drejtën e pronës për truallin prej 82 dynmësh, pjesë e së cilës janë edhe pasuritë e poseduara nga kërkuësit. Ndërkohë që, sipas gjykatave, këta të fundit nuk rezultojnë ta kenë fituar posedimin për truallin objekt gjykimi në mënyrë të ligjshme, në kushtet kur vendimi i gjykatës së apelit mbi të cilin ata kanë mbështetur pretendimet e tyre nuk ka fuqi ligjore, pasi është bazuar në një vendim tjetër të gjykatës së apelit, që është prishur në vijim nga Gjykata e Lartë. Kjo qasje është përkrahur edhe nga Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë.

36. Në vlerësimin e Kolegjit, pretendimet e ngritura nga kërkuësit përgjatë procesit gjyqësor për të drejtën e pronës dhe parimin e sigurisë kanë marrë përgjigje të arsyetuara nga gjykatat e zakonshme në përputhje me kompetencat e tyre dhe arsyetimi i vendimeve gjyqësore të kundërshtuara nuk rezultojnë të jetë arbitrar ose haptazi i paarsyeshëm, pra që të bjerë ndesh me konceptin e gjykimit të drejtë, ose që të mos respektojë standardet kushtetuese të një vendimi të arsyetuar. Për rrjedhojë, edhe fakti që Gjykata e Lartë ka vendosur mospranimin e rekursit të paraqitur nga kërkuësit nuk është i mjaftueshëm në aspektin kushtetues për të vënë në dyshim procesin gjyqësor të zhvilluar nga ajo gjykatë.

37. Për sa më sipër, Kolegji çmon se pretendimet e kërkuësve për cenimin e standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor të lidhur me të drejtën e pronës private dhe parimin e sigurisë juridike, janë haptazi të pabazuara.

38. Në përfundim, Kolegji vlerëson se ankimi kushtetues individual nuk plotëson kriteret ligjore paraprake për pranimin e tij për shqyrtim në seancë plenare.

### **PËR KËTO ARSYE,**

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese, bazuar në nenet 31 dhe 31/a, pika 2, shkronjat “a” dhe “e”, të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar,

### **V E N D O S I:**

Moskalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare.